REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2019:156081

Datë: 26.08.2019

Numri i dokumentit: 00476315

C.nr.66/2019

Gjykata Themelore Gjilan-Dega në Kamenicë, **Departamenti i Përgjitshëm,** përmes gjyqtarit Besnik Pireva, në çështjen juridike kontestimore të paditësi F.Th nga fshati ..., Komuna Kamenicë, të cilën me autorizim e përfaqëson av. S.S nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës - Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson A.H nga Kamenica, për shkak të pagimit të tri pagave përcjellëse dhe shpërblimit jubilar pas pensionimit, vlera e kontestit 1919,32 €, në seancën për shqyrtim kryesor më datë 15.08.2019, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.Th nga fshati ...., Komuna Kamenicë, **dhe detyrohet e paditura** Komuna Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, **që paditësit t'ia paguaj dhe atë:** në emër të shpërblimit jubilar dhe atë për 100% të një page bazë shumën prej 479.83 €, si dhe në emër të tri pagave mesatare për përcjellje në pension shumën prej 1439.49€, apo shumën e përgjithshme në vlerë prej 1919.32€**,** me kamatë prej 8%, duke e llogaritur nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (15.08.2019) e deri te pagesa definitive, si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 239 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi F.Th nga fshati ...., Komuna Kamenicë, përmes të autorizuarit të tij av. S.S nga Kamenica, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të shpërblimit jubilar dhe tri pagave mesatare për përcjellje në pension në shumën e përgjithshme në vlerë prej 1919.32€.

I autorizuari i paditësit ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë në seancën e shqyrtimit kryesor me të cilën ka kërkuar që e paditura t'ia kompensoj paditësit në emër të shpërblimit jubilar shumën prej 479.49 € dhe atë në vlerë prej 100% të një page bazë, ndërsa në emër të tri pagave për përcjellje në pension shumën prej 1439.49€, duke shtuar se paditësi F.Th ka qenë në marrëdhënie të punës te e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit në Kamenicë si mësues si Biologjisë dhe Kimisë në disa shkolla të Kamenicës mbi 30 vite dhe atë në shkollat: SHFMU "Metush Krasniqi" në ..., SHFMU "Avni Rrustemi" në ..., SHFMU "17 Shkurti" në .... Ka shuar se me që e paditura nuk ja ka pagauar shumat e lartcekura paditësit sipas kërkesës

2019:156082

në procedurën administrative ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për hartimin e padisë në shumë prej 104 € si dhe për një seancë gjyqësore shumën prej 135€.

Përfaqësuesi i autorizuar i të padituës A.H në seancën për shqyrtim kryesor e ka kontestuar kërkesëpadinë në tërësi si të pabazuar, me arsyetimin se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive por nënshkrues e kësaj kontrate kolektive është Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa nuk e ka kontestuar provojnë e punës dhe larësin e pagës neto për paditësin.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike ka bërë administrimin e provave si: aktvendimi me numër të referencës 110 i datës 26.04.2019, vërtetimi me numër 30/2019 të datës 25.04.2019, vërtetimi me numër 26 të datës 24.04.2019, vërtetimi me numër 22 të datës 30.04.2019, vërtetimi me numër 26 të datës 20.05.2019 dhe kërkesa me numër 120 e datës 10.05.2019, përgjigjja në kërkesë me numër 13366 të datës 13.05.2019, e pas administrimit të këtyre provave një nga një dhe të tërave bashkërisht në kuptim të nenit 7 dhe 8 të LPK-së, ka vërtetuar gjendjen faktike prej nga ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Edhe pse nuk ishte kontestuese në mesë palëve, gjykata nga leximi i vërtetimeve me numër 30/2019 të datës 25.04.2019, me numër 26 të datës 24.04.2019 dhe vërtetimit me numër 22 të datës 30.04.2019, vërtetoi faktin se ish-punëtori arsimor F.Th kishte qenë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe i njëjti kishte provojë të punës mbi 30 vite.

Edhe pse nuk ishte kontestuese në mesë palëve, gjykata me leximin e vërtetimin numër 26 të lëshuar nga SHFMU ”17 Shkurti” Muqivërc i datës 20.05.2019, provoj faktin se ish punëtori arsimor F.Th në tre muajt e fundit kishte realizuar pagën në shumën prej 479.83€.

Me leximin e vendimit me numër 110 të datës 26.04.2019, vërteton faktin se F.Thme datë 01.05.2019 mbush moshën 65 vjeçare duke plotësuar kushtin e paraparë për pensionim.

Me leximin e kërkesës drejtuar DKA në Kamenicë nr.12795 të datës 06.05.2019 të ushtruar nga paditësi dhe në përgjigje të kërkesës nr.13366 të datës 10.05.2019 vërtetohet fakti se e njëjta është refuzuar nga e paditura me arsyetimin se kompensimin i tri pagave përcjellëse për pension dhe shpërblimit jubilar nuk mund të realizohet për arsye të mungesës së buxhetit.

Gjykata kërkesëpadinë e paditësit e aprovoi në tersi si të bazuar dhe e ka obliguar të padituën, që t’ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar për mbi 30 vite përvojës së punës në vlerë të 100% të një page bazë , respektivisht shumën prej 479.83€ si dhe tri (3) pagave mujore për përcjellje në pension (3x479.83€,) në vlerë prej 1439.49€, të gjitha këto në shumë prej 1919.32€, duke u bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive, konkretisht në nenin 35 parag.8 pika 3 shprehimisht është përcaktuar se *‘’Punëtorët në vitet jubilare të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të 100% të një page bazë”*, ndërsa në paragrafin 9 të të njëjtës dispozitë parasheh se “*punëtorët*

2019:156082

që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit".

Pretendimet e të paditurës se kërkesëpadia është e pabazuar nga arsyetimi se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive, gjykata pretendimet e lartcekura i vlerësoi si të pabazuara nga fakti se me Ligjin për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës numër 03/L-068, në nenin 5 janë rregulluar kompetencat e komunave në nivelet 0,1,2 dhe 3 të arsimit publik, ku në pikën c) të kësaj dispozite parashihet kompetenca e të paditurës për punësimin e mësimdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave, ndërsa në pikën f) të dispozitës së lartcekur parashihet kompetenca e të paditurës për pagesën e stafit menaxherial si dhe të personelit tjetër të punësuar. Konform dispozitave ligjore të lartcekura, dispozitat e Kontratës Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (në rastin konkret Komuna-DKA), ashtu siç parashihet me nenin 2 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Edhe me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, parashihet se sa i përket çështjeve të punëdhënësit me punëmarrësin ata të drejtat dhe detyrimet e tyre mund ti rregullojnë edhe me Kontratë Kolektive dhe Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me ligj të punës, pra të drejtat e punëmarrësit me Kontratën Kolektive mund të avancohen më lartë se të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Gjykata lidhur me kërkesë për kamatën ka vendosur në mbështetje të nenit 382 paragrafi 2 të LMD-së.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenin 452 parag. 1 të LPK-së, dhe atë ka përfshirë punën për shpërblimin e përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, për përpilimin e padisë shumën prej 104€, dhe për një seancë gjyqësore shumën prej 135€, sipas TA të OAK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore Gjilan- Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.66/2019, më dt. 15.08.2019

G j y q t a r i
Besnik Pireva, d.v

KËSHILLA JURIDIKE - Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.